



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes : 61012-03018-11-2018      Data e Regjistrimit : 03/12/2018  
Numri i Vendimit: 11-2018-6769                      Data e Vendimit : 27/12/2018

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Paulin Çera

SEKRETARE: Entila Shkurti

Sot më datë 27/12/2018mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues {...}i, i biri i {...} dhe i {...}, i datëlindjes {...}

**Objekti:**Kërkohet revokimi i masës sigurimit pasuror sekuestro preventive vendpsur me vendimin Nr.70/1 datë 13/03/2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës lene ne fuqi me vendimin nr.65/10-2018-739 datë 05/04/2018 të Gjykatës Apelit Durrës.

**Baza Ligjore:**Nenet 260, 276 të K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi çeli seancën gjyqësore, kreu verifikimin e prezencës së palëve dhe shqyrtoi aktet e fashikullit, pretendimet dhe provat e palëve të cilët kërkuan:

**Kërkuesi {...} dhe mbrojtësi i tij ligjor:** "Heqjen e masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive të vendosur me vendimin Nr. 70/1, datë 13.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr. 65/10-2018-739, datë 05.04.2018";

**Prokuroria:** "Pranimin pjesërisht të kërkesës në këtë mënyrë: -lejimin e kryerjes së punimeve të ndërtimit në objektin " {...}" në pasurinë me nr. {...}, në pronësi të shtetasit {...}i, me sipërfaqe m2 dhe adresë {...}; - ndërsa në lidhje me pezullimin e kryerjes së transaksioneve në pasurinë me nr. {...},i regjistruar ne Vol {...}, me sipërfaqe {...}m2 dhe S.nd= {...} m2 në pronësi të shtetasit {...}, duhet të vazhdojë për shkak se ka nevojë të kryhen hetime në lidhje me legalizimin e truallit dhe bashkimin e pasurive.",

VEREN :

Vëren:

## I. Rrethanat e çështjes.

Në datë 03.12.2018 kërkuesi, {...} i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke kërkuar heqjen e masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive të vendosur me vendimin Nr. 70/1, datë 13.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultojë e provuar se me kërkesën e prokurorisë së datës 13.03.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin Nr. 70/1, datë 13.03.2018 ka vendosur: "1. Pranimin e kërkesës Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. 2. Vendosjen e masë së sigurimit, sekuestro preventive duke urdhëruar: -Pezullimin e kryerjes së mëtejshme të punimeve të ndërtimit në objektin " {...} " në pasurinë me nr. pasurie {...} në pronësi të shtetasit {...} me kufijtë (V/J/L/P) me sipërfaqe {...} m2 dhe adresë lagje {...}. -Pezullimi i kryerjes së transaksioneve në pasurisë me nr. {...}, regjistruar në Vol 1 {...}, me sipërfaqe {...} m2 dhe S.nd = {...} m2 në pronësi të shtetasit {...}. 3. Përzbatimin e këtij vendimi urdhërohet IKMT Tiranë, IMT Bashkia Durrës, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës dhe ZVRPP Durrës. 4. Kundërkëtitj vendimi mund të bëhet ankim brenda 10 (dhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, nga cilido që ka interes. Ky afat fillon nga dita edhënies së këtij vendimi ose nga dita që i interesuari ka marrë djenë."

Si rrethana fakti në këtë vendim janë pranuar sa vijon: "Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, mbi bazën e referimit të bërë nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, në datë 13.02.2018 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal Nr. 247, për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Më datë 08.03.2018 është proceduar me regjistrimin e emrit të shtetasit {...} me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Durrës, si person që i atribuohet veprapenale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal. Nga hetimi i kryer dhe aktet e administruara, rezulton se: Me vendimet Nr. 101, datë 17.02.2017 dhe Nr. 463, datë 04.08.2017 të Bashkisë Durrës, është miratuar Leje Zhvillimi dhe Ndërtimi, për pasurinë nr. pasurie {...}, në pronësi të shtetasit {...} me sipërfaqe {...} m2 dhe adresë lagje {...}, për objektin "Hotel, Shërbime Turistike dhe Zyra, dyqane me shumicë dhe pakicë, dyqane, zyra publike dhe private". Objektipozicionohet midis, rrugës "Ura e Dajlanit" dhe bregut të detit.

Gjatë procedurës administrative të verifikimit të dokumentacionit dhe zonës ku kërkohet zhvillimi i pronës dhe ndërtimi i objektit, Bashkia Durrës, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, me shkresën Nr. {...} datë {...} ka sqaruar Autoritetin Rrugor Shqiptar, se bazuar në hartën e Infrastrukturës së Propozuar (Rrjeti Rrugor i Propozuar) pjesë përbërëse e Planit të Përgjithshëm të qytetit Durrës dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të qytetit Durrës (tabela 8, faqe 85) "Prospekti i aplikimit të distancave të ndaluarave për ndërtimin në afërsi të gjithë kategorive të rrugëve" mbikalimi i Urës së Dajlanit (rampa ngjitëse dhe zbritëse) Klasifikohet rrugë e tipit "A" Autostradë dhe për ndërtime e reja, distanca që objektet duhet të ruajnë nga kjo kategori Rruge duhet të jetë 30 metra. Me përgjigjen Nr. {...}, datë {...} (protokoluar në Bashki me nr. {...}, datë {...}) të Autoritetit Rrugor Shqiptar, është përshkruar se "me sqarimet e dhëna nga ana juaj se objekti shtrihet përgjatë rampave, si dhe referuar neni 18.3 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", distanca për ndërtime nga rampa e jashtme është 20 metra".

Me procesverbalin "I këqyrjes në vendit të ngjarjes", datë {...}, ka rezultuar se distanca e kolonave të pjesës veriore deri tek kufizuesi anësor i rrugës që të çon tek rampa e "Urës së Dajlanit" ka një gjatësi prej 20.2 metra. Nga faqja veriore e murit të katit nëntokë të objektit, deri tek rampa e " {...} " ka një gjatësi 12.2 metra. Ndërkohë nga faqja e murit të pjesës jugore të objektit deri në vijën e ujit të detit, ka një gjatësi lineare prej 47 metra. Gjithashtu dhe në plan-vendosjen e paraqitur nga zhvilluesi i pronës, rezulton se objekti në pjesën jugore dhe perëndimore është shumë afër bregut të detit, ku në plan-vendosje është shkruar **ranishte**. Prokuroria ka parashtruar se përfaqësues të Bashkisë Durrës dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në këtë Bashki, si organe përgjegjëse për ushtrimin e veprimtarive të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit, gjatë procesit të pranimit, verifikimit dhe marrjes së vendimeve nga Kryetari i Bashkisë Durrës, kanë vepruar në mospërbushje të rregullit të detyrës së parashikuar nga neni 14.1 të ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, dhe neni 21.2 të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar, për këto arsye:

**Së pari:** Në bazë të nenit të ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, **zona ku është dhënë leja e zhvillimit dhe ndërtimit**, është zonë e përcaktuar si zonë e **Rëndësisë Kombëtare** dhe për shqyrtimin e kërkesave për leje të zhvillimit dhe ndërtimit në këto zona është Këshilli Kombëtar i Territorit, organ kompetent përgjegjës për të miratuar lejet e zhvillimit dhe të ndërtimit për këto zona...Në vendimin Nr. 1, datë 08.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit, në pikën "1.1" të tij, është përcaktuar si zonë me **rëndësi kombëtare, dhe Brezi Bregdetar** (sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi) Pasuria nr. pasurie 8514-5/19, ZK 8514, në emër të shtetasit {...} me sipërfaqe 1516.8 m2 është brenda kufirit të ndaluar për ndërtime...Me vendimit Nr. 02, datë 14.06.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për Miratimin e planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar" në pikën "2" germa "b" dhe "c" ka parashikuar si pjesë përbërëse të Planit të Integruar Ndërsektorial, dhe **Brezin Bregdetar**. Në hartën e miratuar bashkëlidhur këtij vendimi është parashikuar se kufiri i lejuar për ndërtime është **200 m nga bregu i Detit...Së dyti:** Zona ku është dhënë leja e zhvillimit dhe e ndërtimit është zonë e mbrojtur dhe nga ligji Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore". **Së treti:** Në zbatim të pikës "7" të vendimit nr. 5, datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit Urban" është parashikuar se "Deri në hartimin e planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planeve Vendore për njësitë e reja territoriale, **propozimi për ndërtim** brenda zonave të identifikuar në këtë vendim, **miratohet** vetëm pas konfirmimit nga AKPT dhe informimit të Këshillit Kombëtar të Territorit..."

Me shkresën Nr. {...}, datë {...} të Bashkisë Durrës, është administruar struktura e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Durrës, e cila drejtohet nga shtetasi {...}, i emëruar në këtë detyrë me kontratim Nr. {...}, datë 0 {...}. Sipas shkresës së mësipërme, rezulton se në procedurën e procesit të pranimit, verifikimit dhe relativitetit për vendimmarrjetek Kryetari i Bashkisë Durrës, kanë marrë pjesë dhe specialistët {...}, me detyrë Sekretare Teknike pranë kësaj drejtorie, me detyrë specialist pranë Sektorit të Planifikimit dhe Kontrollit të zbatimit të lejeve dhe {...}, me detyrë specialiste pranë Sektorit të Kontrollit të Zhvillimit të Zhvillimit të Territorit, në këtë Drejtori. Me shkresën Nr. {...}, datë {...} të Bashkisë Durrës, është administruar një kopje e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor për ish-territorin e Bashkisë Durrës. Në këtë shkresë, prokuroria është informuar se aktualisht Bashkia Durrës, nuk ka miratuar asnjë PDV (Plan të Detajuar Vendor), ndërkohë për sa i përket vendimit nr. 02, datë 14.06.2016 "Për Miratimin e planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar", mund të konsultohet online në adresën elektronike [www.planifikimi.gov.al](http://www.planifikimi.gov.al) – PINS Bregdeti."

Në këtë vendim është arsyetuar ndër të tjera sa vijon: "...Referuar rrethanave të faktit dhe akteve që ndodhen bashkëlidhur kërkesës së prokurorit, Gjykata vlerëson se ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim {...} me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Durrës, gjatë procedurës së pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga shtetasi {...} ka vepruar në mos përbushje të rregullit të detyrës, dhe si pasojë e këtyre veprimeve të paligjshme është dhënë leja e zhvillimit dhe e ndërtimit në emër të shtetasit {...}. Po ashtu në funksion të këtij procedimi është administruar dokumentacioni i regjistrimit të pronësisë me nr. pasurie {...}, në pronësi të shtetasit {...}, me sipërfaqe {...} m2 dhe adresë {...} Plazh, Durrës.

Nga aktet e administruara rezulton se Pasuria me nr. {...}, sip {...} m2 (ref. {...} - leje nr. {...} datë {...}), nr. {...}, sip {...} m2 (ref {...} - leje nr. {...}, datë {...}) dhe nr. {...}, {...} m2 (ref {...} - leje nr. {...} datë {...}), janë legalizuar nga ALUIZNI Durrës, me lejet e legalizimi. Ndërsa pasuria me nr. {...}, sip {...} m2 (ref {...} - me kompensim sipas vendimit nr. {...}, datë {...}), datë {...} të KKK Pronave Durrës, për të cilin ka një procedim penal me nr. {...}. Të gjitha këto pasuri janë bashkuar dhe meurdhryn nr. {...}, datë {...} të ZVRP Paluajtshme është proceduar me korigjimin e kufirit dhe të konfiguracionit të truallit në H.T.R,

të pasurisë truall me nr. {...}, regjistruar në Vol {...}, me sipërfaqe {...} m2 dhe S.nd = {...} m2 në pronësi të shtetasit {...}. Legalizimi i tre objekteve në data {...} {...} dhe {...} nga përfaqësues të ALUIZNI-t, Durrës, dyshohet se është kryer në kundërshtim me nenin 2.4/2 të ligjit nr. Nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" (i ndryshuar me ligjin Nr. 9895, datë 09.06.2008) në të cilin është parashikuar se "Fusha e zbatimit të këtij ligji nuk shtrihet përndërtimet informale brenda një distance prej 100 metrash nga akset rrugore kombëtare, me përjashtim të rasteve kur ndërtimi informal përfshihet brenda një zone informale të miratuar". Sa më sipër, konstatohet se procedura për legalizimin e objekteve dhe trojeve si dhe ajo lejës së zhvillimit dhe ndërtimit janë dhënë në mospërbushje të rregullt të detyrës.

Ndodhur në këto kushte, Gjykata e gjen të drejtë kërkesën e prokurorisë që në bazë të nenit 274/2 të Kodit Penal, mbi truallin dhe objektin e mësipërm të vendoset sekuestro preventive duke urdhëruar pezullimin e kryerjes së mëtejshme të punimeve në ndërtimin e objektit dhe të kryerjes së transaksioneve për këtë pasuri në emër të shtetasit {...}. Gjykata konkludon në këtë vendimarrje pasi së pari, ka indicje dhe prova me të cilat provohet se personi nën hetim {...} e ka kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës në drejtim të pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit për dhënien e lejes për zhvillim e ndërtim të objektit " {...} në pasurinë me nr. pasurie {...}, në pronësi të shtetasit {...}, dhe së dyti, ka rrezik që disponimi i lirë i sendit që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose zgjasë pasojat e saj. Kjo pasi referuar procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes së datës 31.01.2018 dhe akteve të tjera, objekti është në ndërtim e sipër."

Kundër këtij vendimi është ushtruar ankimi dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr. 65/10-2018-739, datë 05.04.2018 ka vendosur: "Lënien në fuqi të vendimit nr. 70/1, datë 13.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës". Në këtë vendim është arsyetuar ndër të tjera sa vijon: "Pretendimi në ankim se {...} është bërë pronar i tokës truall në një procedurë të rregullt ligjore dhe është në mirëbesim është një pretendim i pabazuar. Për të përcaktuar qenien ose mos qenien në mirëbesim analizohet ana subjektive e tij, duke iu referuar kujdesit minimal, si dhe aftësive të një njeriu mesatar. Pavarësisht se është përgjegjësi e ZVRPP Durrës të pasqyroj në certifikatën e pronësisë nëse toka objekt sekuestro është tokë truall, apo ranishte, të verifikoj vlefshmërinë e titullit të pronësisë, certifikata e lëshuar nga ZVRPP Durrës nuk prezumon faktin se ankuesi është në mirëbesim nëse ekzistojnë indicje se personat shitës të kësaj pasurie e kanë fituar atë në mënyrë të parregullt. Gjykata vlerëson se në momentin e blerjes, ankuesi me një përkujdesje normale do të vërente se objektet e legalizuara ishin të një sipërfaqe shumë të vogël në raport me sipërfaqen e truallit të legalizuar dhe vendndodhja e saj është në një zonë që ka rrezik të madh që legalizimi të refuzohet, pasi është zonë bregdetare dhe këto zona janë të përjashtuara nga legalizimi. Në vazhdim të hetimeve duhet të verifikohet nëse çmimi i blerjes është afër çmimit të tregut dhe arsye pse ankuesi ka anuluar kontratën e sipërmarrjes dhe ka realizuar kontratë shitje. Këto indicje tregojnë se ka dyshime se ankuesi nuk ka qenë në mirëbesim në blerjen e kësaj prone. Pretendimi në ankim se kjo pasuri nuk mund të sekuestrohet pasi nuk rezulton pasuri që mund të konfiskohet sipas nenit 36 të Kodit Penal është i pabazuar. Nëse nga hetimi vërtetohet se truall është përfitur nga procedura e legalizimit në mënyrë të paligjshme dhe ankuesi kontratën e blerjes dhe marrjen e lejes së ndërtimit i ka bërë me qëllim që të transformojë pasurinë e paligjshme, atëherë kjo pasuri rezulton si produkt i veprës penale dhe në zbatim të nenit 36 të Kodit Penal mund të konfiskohet. Gjykata e Apelit çmon se plotësohet edhe elementi tjetër i rrezikut të shtimit të pasojës kriminale nëse sendi nuk do të sekuestrohet, pasi disponimi i pasurisë së sekuestruar mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera dhe në rrethanat si më sipër, Gjykata e Apelit vlerëson si të drejtë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të papranueshme pretendimet e kërkesës ankimore". Në kushtet e mësipërme prokuroria ka vijuar me kryerjen e hetimeve, ndërsa kërkuesi {...} në datë 03.12.2018 i është drejtuar gjykatës me kërkesën objekt gjykimi duke parashtruar se menjëherë pas marrjes së vendimit nga gjykata, Inspektor të IMT Bashkia Durrës dhe policia gjyqësore pranë Prokurorisë kanë bllokuar punimet e filluara me leje të rregullt ndërtimi. Nga ana e akuzës gjatë kësaj kohe janë kryer një sërë veprimesh hetimore sikurse janë dy akte ekspertimi të pavarura nga njëri tjetri të cilët kanë dalë në konkluzionin kategorik se nuk kemi para asnjë lloj shkeljeje të ligjeve e normave në fushën e ndërtimit e planit rregullues të Bashkisë Durrës. Kërkuesi ka vazhduar se është pronar i një sipërfaqe truall prej {...} m2, e cila ndodhet në lagjen {...} e provuar kjo me certifikatën e lëshuar në datë {...}. Pak kohë më parë i jam drejtuar KRRT Bashkia Durrës, ku kam kërkuar të zhvilloj pronën time dhe për këtë pajisjen me leje ndërtimi për një objekt {...}. Bashkia Durrës ka lëshuar lejen e ndërtimit Nr. {...} datë {...} në emër të shoqërisë " {...}. Me marrjen e lejes së ndërtimit kanë filluar punimet të cilat janë në fazën e përfundimit të katit të dytë. Nga vendimi gjyqësor Nr. 70/1, datë 13.03.2018 jam vënë në dijeni se ndaj meje nuk është regjistruar procedim penal në prokurori dhe sepezuallimi i punimeve në objektin tim është bërë se ndaj shtetasit {...} me detyrën e Drejtorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Durrës është regjistruar procedim penal si i dyshuar për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Sipas prokurorisë shtetasi {...} ka kryer shkelje në dhënien e lejeve të ndërtimit duke përfshirë edhe lejen time, ndërsa vërehet se në të njëjtën zonë ku unë kam filluar ndërtimin janë bërë edhe objekte të tjera nga persona të ndryshëm të cilat sot gëzojnë frytet e investimit, ndërsandërtimi im jo. Megjithatë, nga një interpretim i të gjitha dispozitave të cituara në kërkesë nga ana e organit të akuzës dhe të përsëritura në vendimet e gjykatave, vërejmë se asnjëra prej tyre nuk është interpretuar drejt nga ana e akuzës (sikurse është neni 7.1/c të ligjit 107/2014).

Unë ankuesi jam qytetar i lirë i këtij vendi dhe duke qenë i tillë nuk kam pranuar të bëj asnjëherë shkelje të asnjë lloj karakteri e jo më penal duke qenë se pronën time prej {...} m2 me nr. pasurie {...}, ndodhur në ZK {...} e kam blerë nëpërmjet një transaksioni në mënyrë të rregullt e të ligjshme, sipas përcaktimeve të ligjit. Unë ankuesi jam në mirëbesim jo vetëm me ligjin por edhe me shtetin e shoqërinë në tërësi, për aq kohë sa unë disponoj lirisht pronën time duke u pajisur me leje ndërtimi brenda të gjitha rregullave nga Bashkia Durrës. Me heqjen e masës së sigurimit për vetë drejtorin e DPZHT, mendoj se vetë akuza do të duhet të hiqte një masë të tillë sikurse është sekuestro preventive marrë ndaj pasurisë time. Objekti është në ndërtim e sipër dhe pezullimi i punimeve nuk do të sillte ndryshime në gjendjen e pasurisë përveçse se ky pezullim do të sillte pasoja të dëmshme e të pariparueshme në ekonominë time e personin tim, pasi për këtë ndërtim kam harxhuar, por kam edhe një kredi bankare gjë të cilën në planin e biznesit, me pezullimin e punimeve falimentojë tërësisht dhe hyj edhe në marrëdhënie borxhi, jo vetëm me bankën por edhe me shoqërinë ndërtuese dhe nënkontraktuese të saj, marrëdhënie këto që do më sillnin mjaft probleme jo vetëm financiare por edhe shoqërore, deri në falimentim të plotë. Disponimi i lirë i pronës time nuk mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e një veprë penale që e përsërisim nuk është veprë penale që dyshohet se e kam kryer unë. Faza e procedimit penal lidhur me caktimin e masave të sigurimit konsiderohet si proces në procesin penal dhe ka funksion aksesor e incidental, në raport me procedimin kryesor mbi hetimin e më pas ushtrimin e ndjekjes penale dhe vërtetimin e themelit të akuzës së paraqitur në gjykim. Në rastin konkret akuza është ngritur për tjetër njeri dhe si send i cili sekuestrohet është sendi në pronësi time, gjë e cila është paradoks i cili në gjykatë nuk mund të kalojë.

Nga ana tjetër, prokurori i çështjes parashtrorë se bazuar në referimin e ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, kjo prokurori ka regjistruar procedimin penal nr. 247, datë 13.02.2018, që bën fjalë veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal. Më datë 08.03.2018 është proceduar me regjistrimin e emrit të shtetasit {...}, me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Durrës, si person që i atribuohet vepra penale shpërdorimi i detyrës. Nga hetimi rezulton se, me vendimet nr. {...}, datë {...} dhe {...}, datë {...} të Bashkisë Durrës, është miratuar Leje Zhvillimi dhe Ndërtimi, në pasurinë nr. pasurie {...}, me sipërfaqe 1516.8 m2 dhe adresë {...}, për objektin " {...} qane me shumicë dhe pakicë, dyqane, zyra publike dhe private" në pronësi të shtetasit N {...}. Në funksion të hetimit shkresën nr. {...}, datë {...} të Zyrës Vendore të Pasurive të Paluajtshme është administruar dokumentacioni i regjistrimit të pasurisë nr. {...} e cila ka origjinën nga bashkimi i pasurive si më poshtë: {...} m2 e fituar me kontratë shitje nr. {...}, datë {...} emër të shtetasve {...} dhe {...} dhe lejes së legalizimit (Referencë nr. {...}); 2. nr. {...} m2 e fituar me kontratë shitje nr. {...}, datë {...} emër të shtetasve {...} dhe lejes së legalizimit (Referencë nr. {...}); 3. nr. m2 e fituar me kontratë

shitje nr. {...}, datë {...} në emër të shtetasit {...} dhe lejes së legalizimi (Referencë nr. {...}); 4 nr. {...}

S nd = {...} m2 në e fituar me kontratë shitje nr. {...}, datë {...} në emër të shtetasit {...} dhe lejes së legalizimi (Referencë nr. {...}); 5. nr. m2 në pronësi shtet.

Të gjitha pasuritë e mësipërme janë bashkuar me Urdhrin nr. {...}, datë {...} të Regjistruesit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, është bërë korigjimi i kufirit dhe konfiguracionit të truallit në HTR, duke ju referuar plan rievimit të hartuar nga Ing. topograf {...} dhe deklarates noteriale nr. {...}. Datë {...} dhe nr. {...}, datë {...}. Më pas pasuritë nr. {...}, nr. {...} nr. {...}

nr. {...} dhe nr. {...}, janë bashkuar dhe regjistruar në pasurinë me nr. {...}, ZK {...} e regjistruar në vol {...}, faqe {...} me str = {...} m2 dhe snd = {...} m2, në pronësi të shtetasit {...} (referenca me nr. {...}). Në funksion të hetimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Durrës me vendimin Nr. 70/1 datë 13.03.2018, ka vendosur pezullimin e kryerjes së mëtejshme të punimeve në këtë truall dhe pezullimin e kryerjes së transaksioneve në këtë pasuri. Në funksion të hetimit është administruar një akt ekspertimi teknik i muajit Tetor 2018 i kryer nga shtetasit {...}, {...}, {...} dhe {...}, në cilësinë e përfaqësuesve të Institutit i Ndërtimit, Tiranë.

Në konkluzionet e aktit të ekspertimit në pikën III germa "b" është përshkruar se Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Plani Integruar Ndërkushtetor për Bregdetin, 5.9.5.. është përcaktuar se-01. Për akomodimin e flukseve të turizmit Det – Diell (plazh) Bashkitë e kësaj fashe duhet të vendosin në PPV-të përkatëse, zonat e lejuara të zhvillimit të turizmit të përmendura më lart. - 02. Objekti është brenda vijës së ndërtimit e cila kufizohet edhe nga shëtitorja bregdetare e zonës së plazhit, në përputhje me planin e përgjithshëm vendorë Bashkia Durrës, i miratuar me vendimin nr. 27, datë 10.05.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit. 03. Referuar planit të Përgjithshëm Kombëtar, Planit të Integruar Ndërkushtetor për zonën Tiranë Durrës, Harta e Sistemit Urban, nga shpjegimi i legjendës, objekti ndodhet në zonë të urbanizuar. Ky akt ekspertimi është shoqëruar dhe me plan-vendosjen e objektit në raport me bregun e detit dhe objektet përreth. Në lidhje me vendosjen e objektit është kryer dhe një ekspertim teknik topografik i kryer nga shtetësia {...}, nëntor 2018. Në

konkluzionet e saj këtij akti ekspertimi rezulton se: - *Sipas matjeve faktike në terren të objektit të ndërtuar fizikisht, rezulton se ai është ndërtuar në përputhje me lejen e ndërtimit, për shkak të një rotullimi të vogël. 2. Sheshi i ndërtimit pozicionohet në zonën S9. 4 të hartës së përdorimit të detajuar të tokës, miratuar me Instrumentin e Përgjithshëm vendorë Bashkia Durrës, i miratuar me vendimin nr. 27, datë 10.05.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit. Sipas legjendës përkatëse, zona S9. 4 është përcaktuar Zonë Turistike dhe Tregtare.*

Sa më sipër, rezulton se kushtet e zbatimit të masës së sigurimit pasuror të vendosur me vendimin Nr. 70/1 datë 13.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, kanë ndryshuar për shkak se Leje Zhvillimi dhe Ndërtimi, në pasurinë nr. pasurie {...}, me sipërfaqe {...} m2 dhe adresë {...}, për objektin "{...}"

"{...}" në pronësi të shtetasit {...} është dhënë në një zonë për të cilën është miratuar plani

urbanistik dhe ndërtimi i objektit është në përputhje me lejen e ndërtimit. Për këtë arsye, në zbatim të nenit 260.1 e 274.3 të Kodit të Procedurës Penale të pranohet pjesërisht kërkesa për revokimin e masës së sigurimit me karakter ndalues pasuror të vendosur me vendimin Nr. 70/1 datë 13.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, të revokohet duke lejuar kryerjen e punimeve të ndërtimit në objektin "{...}" në pasurinë me nr. pasurie , ZK , në pronësi të shtetasit {...}i, me

kufijtë (V/J/L/P) me sipërfaqe {...} m2 dhe adresë {...}. Ndërsa, në lidhje me pezullimin e kryerjes së

transaksioneve në pasurisë me nr. {...}, i regjistruar në Vol {...}, fq {...}, me sipërfaqe {...} m2 dhe S.nd = {...} m2 në pronësi të shtetasit {...}i, duhet të vazhdojë për shkak se ka nevojë të kryhen hetime në lidhje me legalizimin e truallit dhe bashkimin e pasurive.

## II. Vlerësimi i gjykatës.

Gjykata vlerëson se faza e procedimit penal lidhur me caktimin masave të sigurimit, konsiderohet si "proces në procesin penal", dhe ka funksion aksesor e incidental, në raport me procedimin kryesor mbi hetimin, e më pas ushtrimin e ndjekjes penale dhe vërtetimin e themellit të akuzës së paraqitur për gjykim. Nevojat e procedimit penal, përveç atyre lidhur me lirinë personale, domethënë lirinë fizike të personit të interesuar, mund të kenë të bëjnë edhe me sendet, në masën që ato mund të prekin apo cenojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e procedimit penal; pra, kur prania e tyre mund të rëndojë, apo të zgjasë pasojat e saj, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, apo kur behët fjalë për sende të rrezikshme e të ndaluara me ligj. Në këtë rast flitet për sekuestrimin si një instrument për realizimin e shtrëngimit pasuror, krahas atij personal që ka qëllime të ndryshme.

Procedura, modalitetet, si dhe kufizimet që parashikohen në procedimin mbi caktimin e masave të sigurimit pasuror nga ligji procedural penal, kanë të bëjnë me garantimin e lirive kushtetuese lidhur me pasurinë, siç janë e drejta e pronës, parashikuar nga neni 41/1 i Kushtetutës, si dhe liria e veprimtarisë ekonomike, parashikuar nga neni 11 i Kushtetutës, duke vënë në baraspeshim në vijë të drejtë interesin publik dhe mbrojtjen e shoqërisë nga veprimet kriminale, me të drejtat themelore kushtetuese të individit në raport me ndërhyrjet e shpërpjesëtuara dhe të papërligjura. Nëpërmjet vendimit mbi sekuestrimin e sendeve, autoriteti gjyqësor synon heqjen/blokimin e një sendi/apo pasurie të përcaktuar, nga disponimi i lirë i një subjekti që e zotëron atë, duke i vendosur sendit një detyrim të caktuar, i cili mund të jetë me karakter të përkohshëm apo përfundimtar në rastin e veprimtarive të ndaluara me ligj.

Sa i përket qëllimeve të caktuara që kërkohen të ndiqen me anë të vendimit për sekuestrimin e sendit, në bazë të nevojave procedurale, ligji procedural penal parashikon tre kategori sekuestrimesh. E para ka të bëjë me qëllimin e vërtetimit të fakteve të procedimit dhe përbën një mjet për kërkimin e provës, sipas nenit 208 të KPP; pra sekuestrimi për qëllim mbledhjen e provave materiale, nuk përbën një masë sigurimi pasuror, madje është pikërisht qëllimi për sekuestrimin e provave elementi që dallon këtë institut, nga sekuestrimi preventiv dhe ajo konservative, të parashikuar nga ligji procedural si masa sigurimi pasuror. Sekuestrimi konservativ ka të bëjë me vendosjen e një detyrimi në sendet e luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqet që ligji lejon sekuestrimin e tyre, të pandehurit apo të paditurit civil me qëllim pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, sipas neneve 270-273 të Kodit të Procedurës Penale.

Sekuestrimi preventiv, në bazë të neneve 274-276 të Kodit të Procedurës Penale, urdhërohet në rastin kur ekziston rreziku që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, apo edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. Gjykata, bazuar në analizën sistematike të dispozitës ligjore, vëren se sekuestrimi preventiv mund të urdhërohet për "qëllime të parandalimit" të pasojave apo veprimeve të paligjshme kriminale, në rastet e parashikuara prej pikës "1" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa në rastet e parashikuara prej pikës "2", të po këtij neni, sekuestrimi preventiv mund të urdhërohet për "qëllime të sekuestrimit", sipas përcaktimeve të parashikuara nga neni 36 i Kodit Penal. Në rastin e dytë, kemi të bëjmë me një "goditje" më efikase të avantazheve ekonomike që vijnë si rezultat i veprimtarive kriminale dhe masa në fakt merr trajtën e një sanksioni penal.

Kushtet e nevojshme ligjore për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestrimit preventiv njëllojësisht janë: prania e indicijeve, d.m.th prania e elementit të ashtuquajtur *fumus boni iuris*, si dhe prania e elementit të ashtuquajtur *periculum in mora* (rreziku i vonesës) deri në kalimin e vendimit në gjë të gjykur. Sa i takon elementit të *fumus boni iuris*, në bazë të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se për zbatimin e sekuestrimit preventiv, është e nevojshme hetimi dhe marrja e të dhënave dëshmuuese rreth kryerjes (së mundshme në të ardhmen e afërt) së një fakti që përbën vepër penale të parashikuar dhe të cilësuar në bazë të një dispozite të Kodit Penal, si dhe verifikimi i faktit të një rëndimi, apo zgjatjeje të pasojës së veprës penale, apo të një lehtësime të kryerjes së veprave të tjera penale, në raport me rrethanat dhe veçoritë e faktit konkret të supozuar se është kryer apo do të kryhet.

Objekti i sekuestrimit preventiv përcaktohet shprehimisht në sendet që lidhen me veprën penale të supozuar se është kryer, prandaj nuk duhet lejuar caktimi i masës së sigurimit pasuror të sekuestrimit preventiv përpara se të jetë kryer vepra penale, apo thjesht një shpjegim i normës penale abstrakte. Për këtë arsye, është e nevojshme prania e një sërë indicijeve që lidhin sendin apo pasurinë me natyrën dhe llojin e veprës penale të supozuar nga ana e organit të akuzës në raport edhe me faktet e parashtruara apo të grumbulluara mbi çështjen konkrete. Këto indicje nuk duhet të vlerësohen në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, por mbi baza aktuale dhe konkrete, mbështetur

në të dhëna objektive që hedhin dritë mbi rëndimin, zgjatjen, apo kryerjen e të tjerave veprime kriminale, në raport me cenimin që i bëhet marrëdhënies juridike të mbrojtur nga norma penale. Gjithashtu, gjykata duhet të verifikojë dhe të argumentojë edhe mbi praninë e një sërë indicjeve që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se do të arrihet një vendim dënimi.

Sa i takon praninë së elementit të *periculum in mora*, Gjikata verën se ky element përbën vetë qëllimin e nevojshëm për caktimin e kësaj mase mbi pasurinë, pra në shmangien e ardhjes ose zgjatjes së pasojave nga vepra penale apo të lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale. Në këtë mënyrë, elementi i *periculum in mora*, nuk duhet të konsiderohet si një eventualitet i përgjithshëm e abstrakt, por si një probabilitet realist, që sendi objekt i mundshëm sekuestrimi preventiv, të bëhet shkak rëndues, zgjatës, për veprën penale të supozuar, apo shkak lehtësues për vepra të tjera të supozuara se mund të ndodhin efektivisht. Kjo mbështetur në llojin dhe natyrën e sendit dhe tërësinë e rrethanave konkrete, dhe duke u bazuar në nevoja reale dhe jo gjasa thjesht teorike. Objekti i sekuestros preventive, sipas pikës "1" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, përbëhet nga "sendet që lidhen me veprën penale", domethënë nga marrëdhënia e krijuar midis sendit dhe veprës penale të kryer, apo me të ardhurat që vijnë si rezultat i kryerjes së veprës penale, po të vazhdojë mbajtja e mëtëjshme e sendit. Gjikata çmon se është e kuptueshme që kemi të bëjmë me një raport midis sendit dhe veprës penale, i cili nuk është i rastësishëm, por i konceptuar dhe vënë në funksion të natyrës së veprës penale.

Në rastin e pikës "2" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, objekti i sekuestros përbëhet nga sendet e sekuestrueshme, në kuptim të nenit 36 të Kodit Penal, por të qenit i sekuestrueshëm i sendit, nuk është kusht i vetëm për përligjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, pasi edhe në këtë rast, janë të nevojshme prania e dy këtyre elementëve. *Së pari*: prania e elementit të *fumus commissis delicti*, domethënë që sendi duhet të ketë qenë ai që ka shërbyer apo ai i destinuar për kryerjen e veprës penale, apo se është pikërisht ai që përbën produktin e veprës penale, shpërblimeve, të dhëna, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i së cilit, përbën veprën penale. *Së dyti*, është e nevojshme vërtetimi i një lidhjeje të posaçme, funksionale dhe jo të rastësishme (domethënë të qëndrueshme) midis sendit dhe veprimit penal të kundërligjshëm. Gjikata vëren se, megjithëse kemi të bëjmë me një marrëdhënie midis sendit dhe veprës penale të kryer, jurisprudenca e GjEDNj-së, (Vendimi datë 20.01.2009, Sud Fondi s.r.l, etj. kundër Italisë; vendimi datë 30.08.2007, Sud Fondi s.r.l, etj. kundër Italisë; Vendimi datë 01.03.2007, Geerings kundër Vendeve të Ulëta), ka përcaktuar se gjithsesi nuk mund të mos mbahet në konsideratë edhe verifikimi i veprimit të një personi, si dhe duhet të përjashtuar konfiskimi ndaj subjekteve që gjenden jashtë rrethanave të kryerjes së veprës penale, për të cilët provohet prania e mirëbesimit.

Duke iu kthyer rastit objekt gjykimi, Gjikata vëren se ka vend për të pranuar kërkesën e kërkuetit {...}, duke urdhëruar heqjen e masës së sekuestros preventive të vendosur me vendimin penal Nr. 70/1, datë 13.03.2018 të Gjikatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lënë në fuqi nga Gjikata e Apelit Durrës me vendimin Nr. 65/10-2018-739, datë 05.04.2018. Gjikata vëren se në nenin 274 pika 3 të K.Pr.Penale është parashikuar se: "3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.". Në rrethanat sa më sipër, Gjikata vlerëson se:

**Së pari**, Gjikata vëren se është vetë organi i akuzës që kërkon heqjen e kësaj mase, duke lejuar kryerjen e punimeve të ndërtimit në objektin " {... }" në pasurinë me nr. {...}, në pronësi të shtetasit {...} me sipërfaqe m2 dhe adresë {...}. Në seancë gjyqësore por edhe në parashtrimet e fundit, prokurori i çështjes u shpreh sekushtet e zbatimit të masës së sigurimit pasuror të vendosur me vendimin Nr. 70/1 datë 13.03.2018 të Gjikatës së Shkallës së Parë Durrës, kanë ndryshuar për shkak se Leje Zhvillimit dhe Ndërtimi, në pasurinë nr. pasurie {...} me sipërfaqe 1 {...} m2 dhe adresë {...} për objektin "Hotel, Shërbime Turistike dhe Zyra, dyqane me shumicë dhe pakicë, dyqan e, zyrapublike dhe private" në pronësi të shtetasit {...} është dhënë në një zonë për të cilën është miratuar plani urbanistik dhe ndërtimi i objektit është në përputhje me lejen e ndërtimit. Në zbatim të nenit 260.1 e 274.3 të Kodit të Procedurës Penale të pranohet pjesërisht kërkesa për revokimin e masës së sigurimit me karakter ndalues pasuror të vendosur me vendimin Nr. 70/1 datë 13.03.2018 të Gjikatës së Shkallës së Parë, Durrës, të revokohet duke lejuar kryerjen e punimeve të ndërtimit në pronësi të shtetasit {...}

Gjikata vëren se nga aktet e ndodhura në dosje, rezultojnë se sekuestro preventive është vendosur për shkak se shtetasi {...}, me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Durrës është marrë si person nën hetim për veprën penale të "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Dyshimet për këtë shtetas lidheshin me faktin se gjatë procedurës së pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga shtetasi {...} duke qenë me detyrën e Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Durrës, ka vepruar në mos përbushje të rregullt të detyrës, parashikuar nga neni 7.1 germa "c", 14.1, 18.6 e 28.1 të ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, të nenit 19.3 germa "a" dhe 45.1 germa "a" të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullues së Zhvillimit të Territorit" i ndryshuar, pikës "1.1" të vendimit Nr. 1, datë 08.10.2013 dhe pikës "2" germa "b" dhe "c" të vendimit nr. 02, datë 14.06.2016 "Për Miratimin e planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar" të Këshillit Kombëtar të Territorit. Të gjitha, këto veprime kanë sjell si pasojë dhënies e lejes së zhvillimit dhe ndërtimit të objektit nga shtetasi {...}, duke bërë kështu që të konsumojë edhe elementet e veprës penale, për të cilat dyshohet, atë të shpërdorimi i detyrës, parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal.

Në vendimin për caktimin e masës së sekuestros preventive, Gjikata ka marrë në analizë veprën penale për të cilën është dyshuar shtetasi {...} dhe në gjendjen që kanë qenë aktet dhe provat ka vlerësuar se ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ky person gjatë procedurës së pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga shtetasi {...} ka vepruar në mos përbushjet rregullt të detyrës, dhe si pasojë e këtyre veprimeve të paligjshme është dhënë leja e zhvillimit dhe e ndërtimit në emër të shtetasit. Po ashtu në funksion të këtij procedimi është administruar dokumentacioni i regjistrimit të pronësisë me nr. pasurie {...}, në pronësi të shtetasit {...}, me sipërfaqe {...} m2 dhe adresë {...}. Në caktimin e kësaj mase, Gjikata ka vlerësuar se ka indicje dhe prova me të cilat provohet se personi nën hetim {...} e ka kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës në drejtim të pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit për dhënien e lejes për zhvillim e ndërtim të objektit "..." në pasurinë me nr. pasurie {...}, në pronësi të shtetasit {...}, dhe se ka rrezik që disponimi i lirë i sendit që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose zgjasë pasojat e saj. Kjo pasi referuar procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes së datës 31.01.2018 dhe akteve të tjera, objekti është në ndërtim e sipër.

Në gjykimin e kërkesës për heqjen e masës së sekuestros, Gjikata në seanca gjyqësore pyeti përfaqësuesin e prokurorisë në lidhje me ecurinë e procedimit penal të regjistruar në ngarkim të shtetasit {...} dhe nga ana e tij u konfirmua se hetimet janë kryer dhe se do të procedohet duke depozituar në gjykatë kërkesën për pushimin e hetimeve pasi nuk kanë rezultuar elemente të shpërdorimit të detyrës. Duke qenë në këto kushte, Gjikata vëren se ka vend për të pranuar kërkesën e kërkuetit dhe heqjen e masës së sekuestros preventive, pasi sikurse u parashtua në seancë gjyqësore, procedimi penal për llogari të të cilit është vënë sekuestronja do të kërkohet pushimi i tij. E ndodhur në këtë gjendje, dhe me qëllimin që nga sekuestronja të mos vijnë pasojat e saj, Gjikata ka vlerësimin se duhet hequr ajo duke lejuar vazhdimin e kryerjes së punimeve.

**Së dyti**, nga hetimet e kryera rezultojnë se nga ana e organit të akuzës është urdhëruar kryerja e akteve të ekspertimit. Kështu, me akt ekspertimi teknik, të përgatitur në muajin Tetor 2018 nga ekspertet {...} është konkluduar ndër të tjera: "III. Në lidhje me pyetjen e tretë sqarojmë se: Referuar: a) përgjigjeve të dhëna më parë. 01. Plani i përgjithshëm kombëtar nuk ka të përcaktuar tregues zhvillimor. 02. Instituti nuk disponon dokumentacion të plotë në lidhje me këto plane. b) Plani të Përgjithshëm Kombëtar, Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, 5, 9, 5...përcakton se: 01. Për akomodimin e flukut të turizmit Det-Diell (plazh) Bashkitë e kësaj fashe duhet të vendosin në PPV-të përkatëse, zonat e lejuara të zhvillimit të turizmit të përmendura më lart. - 02. Objekti është brenda vijës së ndërtimit e cila kufizohet edhe nga shëtitorja bregdetare e zonës së plazhit, në përputhje me planin epërgjithshëm vendorë Bashkia Durrës, i miratuar me vendimin nr. 27, datë 10.05.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit. 03. Referuar planit të Përgjithshëm Kombëtar, Planit të Integruar Ndërsektorial për zonën Tiranë Durrës, Harta e Sistemit Urban, nga shpjegimi i legjendës, objekti ndodhet në zonë të urbanizuar. 04. Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës synon të drejtojë zhvillimin e

territorit përmes vizioneve që jep në union në Njësitë e Qeverisjes Vendore. 05. Plani i përgjithshëm kombëtar, nuk është plan ndërtimi, siç është në të përcaktohen parime për zhvillimin e këtyre zonave në mënyrë të integruar". Ky akt ekspertimi është shoqëruar dhe me plan-vendosjen e objektit në raport me bregun e detit dhe objektet përreth. Në lidhje me vendosjen e objektit është kryer dhe një ekspertim teknik topografik i kryer nga {...}, Nëntor 2018. Në konkluzionet e saj këtij akti ekspertimi, ndër të tjera është konkluduar se: "- Sipas matjeve faktike në terren të objektit të ndërtuar fizikisht, rezulton se ai është ndërtuar në përputhje me lejen e ndërtimit, për shkak të një rrotullimi të vogël. 2. Sheshi i ndërtimit pozicionohet në zonën {...} të hartës së përdorimit të detajuar të tokës, miratuar me Instrumentin e Përgjithshëm vendorë Bashkia Durrës, i miratuar me vendimin nr. 27, datë 10.05.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit. Sipas legjendës përkatëse, zona S9. 4 është përcaktuar Zonë Turistike dhe Tregtare."

Gjykata vlerëson se ndodhur përpara këtyre akteve të ekspertimit si dhe të shpjegimeve të dhëna nga prokurori në seancë gjyqësore, nuk ka vend për të qëndruar masa e sigurimit preventive ndaj objektit në ndërtim në pronësi të shtetasit {...}. E para, u parashtrua se procedimi penal do të shkojë drejt pushimit të tij për shkak të mungesës së elementeve të veprës penale të shpërdorimit të detyrës; e dyta, sipas akteve të ekspertimit, objekti i ndërtimit të shtetasit {...} është brenda parametrave të përcaktuara nga ligji dhe konform tij. Në lidhje me këtë vendimarrje të saj, Gjykata mban në konsideratë edhe vendimin Nr. 3, datë 13.01.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ku është përcaktuar se në këto raste mund të vendoset heqja e masës së sekuestros dhe jo revokimi i saj. Në tërësi të kërkesës së kërkuarit {...} është kërkuar heqja e masës së sigurimit sekuestro preventive. Në lidhje me pretendimin e prokurorisë se duhet lejuar vetëm kryerja e punimeve të ndërtimit dhe se duhet të vijojë pezullimi i kryerjes së transaksioneve, Gjykata e gjen të pabazuar. Gjykata vlerëson se nuk ka sesi të lejohet përfundimi i ndërtimit dhe nga ana tjetër të pezullohet kryerja e transaksioneve mbi këtë pasuri. Arsye e heqjes së masës së sekuestros lidhet me mos rëndimin e pasojave mbi këtë ndërtim. Por nëse ai lejohet të përfundohet dhe nuk lejohet kryerja e transaksioneve, atëherë pasojat do të jenë më të mëdha. Gjykata vlerëson se nga ana e prokurorisë duhet të qartësohet ajo çfarë kërkohet duke paraqitur në gjykatë prova konkrete mbi të cilat ngrihet dyshimi i arsyeshëm se legalizimet e këtyre objekteve janë bërë në mënyrë të paligjshme (Shih për më tej vendimi Nr. 201, datë 19.12.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë). Sa më sipër, kërkesa e kërkuarit {...} është e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

### Për këto arsye

#### Baza Ligjore:

Gjykata, bazuar në nenin 274/3 të K.Pr.Penale

#### VENDOSI:

#### Vendosi:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Heqjen e masës së sigurimit, sekuestro preventive të vendosur me vendimin Nr. 70/1, datë 13.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lënë në fuqi me vendimin Nr. 65, datë 05.04.2018 të Gjykatës së Apelit Durrës.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 10 (dhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes.

**U shpall, sot në Durrës, më datë 27 Dhjetor 2018.**

#### SHPENZIMET GJYQËSORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

**GJYQTAR:**

**Paulin Çera**